



Aplikimi i Tarifave për 2011

Aplikimi i Tarifave për OSSH sh.a dhe FPP për 2001

OSSH, sh.a.
Bloku “Vasil Shanto”
Tirana
Albania

Përmbledhje

1. Përmbledhje	5
2. Propozime për aplikimin e tarifave për 2011	7
2.1. Parashikimi i kërkesës për Energji	7
2.1.1. Metodologjia e përdorur	7
2.1.2. Numri i konsumatorëve.....	15
2.1.3. Parashikimi i kërkesës për Energji për 2011.....	16
2.2. Norma me norma fiskaleme norma fiskalee	16
2.3. CPI	16
2.4. Norma Këmbimit Valutor	16
2.5. Humbjet dhe kostot e energjisë së importuar	16
2.6. Çmimi i FPSH dhe TSO	18
3. OPEX (SHPENZIMET OPERATIVE)	18
3.1. Ristrukturimi i kompanisë dhe koncepti i Shërbimeve të Përbashkëta	18
3.2. Kostot e Personelit	25
3.3. OPEX TE TJERA - SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE	25
3.4. Përmbledhje totale e Shpenzimeve Operative (OPEX)	28
4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	28
4.1. SHPENZIMET OPERATIVE (OPEX)	28
4.1.1. Parimet e alokimit	28
4.1.2. Parashikimi i shpenzimeve operative - OPEX – për vitin 2011.....	29
4.2. SHPENZIMET KAPITALE (CAPEX)	29
4.2.1. Parashikimi i CAPEX për 2010	30
4.2.2. Parashikimi i CAPEX për 2011	31
4.3. Amortizimi	34

4.3.1.	Amortizimi për vitin 2008	36
4.3.2.	Amortizimi për vitin 2009	36
4.3.3.	Amortizimi për vitin 2010	37
4.3.4.	Amortizimi për vitin 2011	38
4.4.	Llogaritja e kostos mesatare të ponderuar të kapitalit - (WACC).....	42
4.4.1.	Llogaritja e kthimit të lejuar nga Kapitali.....	42
4.4.2.	Kostot e borxheve të vjetra	42
4.4.3.	Kostot e borxheve të reja	42
4.4.4.	Formula e llogaritjes së WACC	44
4.5.	Kapitali punues (Working capital).....	45
4.6.	Baza e rregulluar e asetëve (RAB).....	45
5	FPP (Furnizuesi Publik me Pakicë).....	47
	OPEX - SHPENZIMET OPERATIVE.....	47
5.1.1	Parimet e alokimit	48
5.1.2	Parashikimi i OPEX (Shpenzime Operative) për vitin 2011.....	49
5.2	Borxhet e këqija	49
5.3	Marzhi i FPP.....	50
6	Mekanizmi i kompensimit	50
6.1	Kompensimi i humbjeve për vitet 2009 dhe 2010	51
6.2	Kompensimi i amortizimit për vitet 2009-2010	52
6.3	Kompensimi i formulës së borxhit të keq për vitet 2009 dhe 2010.....	52
6.4	Llogaritja e mekanizmit të kompensimit për vitin 2011	53
7	Kërkesat e të ardhurave dhe shpërndarja e tarifave	54
7.1	Të ardhura të tjera	54
7.2	Të ardhurat e energjisë reaktive.....	55
7.3	Të ardhurat e energjisë në oraret pik.....	56

<i>7.4. Përfshirja e komponentit të tarifës fikse</i>	<i>56</i>
<i>7.5 Paraqitja e tarifës së kërkesës për klientët lidhur në 35 kV dhe 110 kV</i>	<i>61</i>
Lista e Shtojcave – Të gjitha shtojcat do të trajtohen si KONFIDENCIALE.....	66

CONFIDENTIAL

1. Përmbledhje

Duke respektuar Deklaraten Rregullatore, seksioni 1.3 “Programi i Tarifave”, OSSH ju prezanton Aplikimin e Tarifave për vitin 2011. Aplikimi i Tarifave është realizuar duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe respekton të gjitha formulat dhe parimet e parashikuara në Deklaraten Rregullatore.

Kur kemi përlogaritur të ardhurat e Kerkuara për vitin 2011, në kemi marrë në konsideratë supozimet e mëposhtme. Cmimet e KESH Gen, FPSH dhe OST, të cilat përbejnë impute për Shpërndarjen dhe FPP janë supozuar të jenë të njëjta në 2011 krahasuar me 2010. Vleresimet për ecurinë e energjisë elektrike të importuar për humbjet, si dhe ecuria e kursit të kembimit të Leke kundrejt Euros, janë bërë dhe siguruar nga ana e departamenteve të specializuara për të tilla vleresime pranë qendres së ČEZ, a.s.. I kemi kushtuar mjaft vëmendje parashikimit të zhvillimit të kërkesës/konsumit të energjisë elektrike dhe në jemi të bindur se modeli i zhvilluar nga ana jone reflekton të gjitha parametrat me impakt material mbi rezultatin përfundimtar. Energjia e parashikuar për tu shpërndarë konsumatorëve fundorë rezulton të jetë në nivelin 4,1 TWh.

Një nga pjesët më të rëndësishme të zhvillimit të rrjetit të OSSH në të ardhmen janë padyshim projektet e investimeve. OSSH gjithashtu është duke prezantuar strategjinë e investimeve dhe të transformimit të saj në projektet e investimeve për vitin 2011. Investimet e parashikuara për t’u kapitalizuar për vitin 2011 arrijnë në vlerën 4,9 mld Leke, e cila përfaqëson një rritje në aktivitetin e investimeve me përafërsisht 13% krahasuar me vlerën e miratuar për vitin 2010. Këto investime në realitet sjellin vlera shtese ndaj konsumatorëve fundorë si dhe përmirësime në rrjetin e shpërndarjes së Shqipërisë. OSSH është e vendosur të vazhdojë sipas një trajtimi të tillë në rast se situata financiare do të stabilizohet sikundër është një kusht i domosdoshëm dhe i pashmangshëm bindja e bankave për të na siguruar financimin e nevojshëm për projektet e investimeve.

OSSH gjithashtu vazhdon me përpjektet e ristrukturimit duke patur si qëllim zhvillimin e efektivitetit të kompanisë në të ardhmen dhe që të vendosë proceset në të njëjtën linjë me “praktikat me të mira”, jo vetëm brenda ČEZ group por gjithashtu dhe brenda lojtareve të tjera në tregun e shpërndarjes së energjisë elektrike. Pavarësisht faktit se çdo ristrukturim sjell kosto shtese në fillimet e saj, në jemi krenarë që të prezantojmë një kursim në shpenzimet operative mbi 400 milion Leke krahasuar me 2010.

Bazuar në vendimin e ERE, nr.46, datë 14.06.2010, nivelet e humbjeve për vitin 2009 dhe 2010 janë ripercaktuar. Gjithashtu bazuar në marrëveshjen e mëparshme dhe bazuar në rekomandimet e bera nga USAID në kemi rilllogaritur amortizimin për asetet të marra në datën e blerjes. Në jemi duke ndjekur instruksionet dhe propozojmë amortizim për “asetet e vjetra” p.sh. ato që egzistonin përpara privatizimit dhe “asetet e reja” p.sh. ato të kapitalizuara pas privatizimit në dy grupe të vecanta me jetegjëtesi të ndryshme dhe kështu me norma të ndryshme amortizimi. Të dyja termat e përmendura më sipër shkaktojnë impakt në të ardhurat e kerkuara të aprovuara për 2009 dhe 2010 dhe prandaj është llogaritur kompensimi për to. Është përdorur përafërimi “price cap”, prandaj vetëm impakti i këtyre dy ndryshimeve janë marrë në konsideratë.

Të gjitha çfarë përmendem më sipër janë marrë në konsideratë në përllogaritjen e të ardhurave totale të kerkuara për 2011 që arrijnë në nivelin 45,8 mld Leke. Kjo përfaqëson një rritje mesatarisht prej 11.92% krahasuar me 2010. Për më tepër në kemi përllogaritur tarifa individuale për secilin nivel tensioni dhe grup konsumatorësh. Në kemi realizuar disa skenarë të cilat jemi gati të diskutojmë me përfaqësues të ERE-s, si dhe parimet përkatëse përkatëse të alokimit të kostove të DSO dhe FPP mund të jenë subjekte të opinionëve të ndryshme. Sikundër OSSH respekton plotësisht rolin e ERE-s si një rregullator i pavarur, në deklarojmë dëshirën dhe vullnetin tonë të diskutojmë në mënyrë të hapur këto çështje në aspektin e alokimit të drejtë të kostove, duke patur parasysh që ndryshimet e mëdha në tarifën individuale vit pas viti mund të kenë efekte shqetësuese. Megjithatë në prezantojmë impaktin në tarifën bazuar në strukturën aktuale të tarifave dhe, sic përmendem më lart, jemi gati të diskutojmë me tej aspektet përkatëse përkatëse të saj.

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 6 nga 80

Ne jemi ne pritje te javeve qe do te pasojne deri ne vendimin final te ERE-s, gjate se cilave parashikohet nje dialog intensiv dhe diskutime rreth pranimit te Aplikimit te Tarifave. Ne kemi besim te plote se eshte ne interesin tone te perbashket te arrijme ne konkluzione te pranueshme nga te gjithe subjektet e perfshire ne proces,, duke siguruar keshtu zhvillim te metejshem te rrjetit te shperdarjes se energjise elektrike ne Shqiperi, e cilaeshte e arritshme vetem nepermjet nje modeli te biznesit te qendrueshem te Shperndarjes dhe FPP.

2. Propozime për aplikimin e tarifave për 2011

2.1. Parashikimi i kërkesës për Energji

2.1.1. Metodologjia e përdorur

Me qëllim ndertimin e Bilancit të Energjisë, u përdorën vëzhgimet e konsumit të energjisë për periudhën Janar 2009-Qershor 2010 duke supozuar se, në përgjithësi, sjellja konsumatore do të jete e njëjtë dhe konsumi i energjise elektrike do të ketë të njëjtin tendence si në vitet e mëparshme. Gjithashtu, elemente të tjera, si projekti NTL (efekt ne rritjen e konsumit), pastrimi i sistemit të faturimit (efekti ne uljen e konsumit) dhe konsumi i energjise në orët e pikut (efekti ne ndarjen e konsumit në orët e pikut dhe jo-pikut) janë marrë në konsideratë për të ndertuar formulën e përgjithshme të përlllogaritjes së konsumit të energjisë elektrike.

Së pari, kemi llogaritur konsumin e parashikuar për gjysmën e dytë të vitit 2010 (H2 2010) dhe më pas, për vitin 2011.

Më poshtë, do të përshkruajmë hap pas hapi ndertimin e formulës dhe elementet te tjere relevante.

Së pari - Është përlogaritur norma e ndryshimit të nevojës për energji nga gjysma e parë e vitit në raport me gjysmën e dytë dhe nga viti në vit. Formula e mëposhtme (norma mesatare e ndryshimit) merr në konsideratë tendencën e konsumit të energjisë.

$$Norma\ Mesatare\ e\ Ndryshimit = 1 + \left\{ \left(\frac{H2\ 2009}{H1\ 2009} - 1 \right) * 0.5 + \left(\frac{H1\ 2010}{H1\ 2009} - 1 \right) * 0.5 \right\} \quad (1)$$

Ku:

H1 2009 – konsumi aktual i gjysmës së parë të 2009 për TM, TU_{jofamiljare} dhe TU_{familjare}

H2 2009 – konsumi aktual i gjysmës së dytë të 2009 për TM, TU_{jofamiljare} dhe TU_{familjare}

H1 2010 – konsumi aktual i gjysmës së parë të 2010 për TM, TU_{jofamiljare} dhe TU_{familjare}

Siç mund të vëreni, pjesa e parë e formulës vlerëson ecurinë e ndryshimit të kërkesës për energji elektrike nga pjesa e parë në raport me pjesën e dytë të 2009, ndërsa pjesa e dytë e formulës vlerëson ecurinë e ndryshimit të kërkesës për energji elektrike nga viti 2009 deri në gjysmën e parë 2010. Të dy trendet janë konsideruar se kanë të njëjtën peshe specifike në normën mesatare të ndryshimit të kërkesës për energji elektrike.

Së dyti – është llogaritur efekti i projektit të reduktimit të humbjeve jo-teknike (NTL) në konsumin e energjisë elektrike duke u bazuar në targetet dhe rezultatet e këtij projekti.

$$NTL_{efekti\ TU} = (Nr.\ Skuadrave\ NTL * Targeti\ Mujor\ NTL) * 0.98 \quad (2)$$

$$NTL_{efekti\ TM} = (Nr.\ Skuadrave\ NTL * Targeti\ Mujor\ NTL) * 0.02 \quad (3)$$

Formula (2) është përdorur për të përfshirë efektin e NTL në llogaritjen e konsumit të energjisë elektrike në TU dhe formula (3) është përdorur për të përfshirë efektin e NTL në llogaritjet e konsumit të energjisë elektrike në TM. Koeficienti 0,98 dhe 0,02 (përkatësisht 98% dhe 2%) janë përdorur duke u bazuar në studimin e humbjeve të kryer nga PriceWaterhouseCoopers

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

(PWC). Koeficienti përfaqëson efektin e ndarjes së humbjeve jo-teknike ndërmjet TM dhe TU. Ju mund të vëreni se efekti i NTL është përqendruar kryesisht në TU, ku identifikohet pjesa më e madhe e vjedhjeve dhe gjithashtu është marre në konsideratë fakti se shumica e konsumatorëve janë të lidhur në këtë kategori.

Gjithashtu për TU, llogaritja e efektit të NTL është kryer veçmas për kategorinë familjare (formula (4)) dhe kategorinë jo-familjare (formula (5)), duke shpërndarë efektin NTL sipas peshës specifike të konsumit të kategorisë familjare dhe kategorisë jofamiljare të TU për H1 2010 për llogaritjen e H2 2010 dhe sipas peshës specifike të konsumit të kategorisë familjare dhe kategorisë jofamiljare në TU në 2010 për llogaritjen e konsumit të energjisë elektrike për 2011. E përshkruar në detaje formula është si më poshtë:

$NTL_{\text{efekti /familjare}} =$

$$\{(Nr. Skuadrave NTL * Targeti Mujor NTL) * 0.98\} * \frac{Konsumi Familjare H1 2010}{Konsumi Total TU H1 2010}$$

(4)

$NTL_{\text{efekti /jofamiljare}} = \{(Nr. Skuadrave NTL * Targeti Mujor NTL) * 0.98\} *$

$$\frac{Konsumi Jo Familjare H1 2010}{Konsumi Total TU H1 2010}$$

(5)

Ndërkohë për sa i përket TM, llogaritja e efektit NTL është kryer në total, duke përdorur formulën (3) dhe më pas, rezultati është shpërndarë ndërmjet çdo kategorie sipas peshës specifike të konsumit të kategorive në H1 2010 për llogaritjen e H2 2010 dhe sipas peshës specifike të konsumit të kategorive në 2010 për llogaritjen e konsumit të energjisë elektrike për 2011.

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 9 nga 80

Efekti i parashikuar i projektit NTL për H2 2010 është reduktimi i humbjeve në nivelin 64 296 MWh dhe për vitin 2011 në nivelin 128 592 MWh.

Së treti – metoda e llogaritjes ka marrë në konsideratë efektin e pastrimit të sistemit të faturimit nga konsumatorët fiktivë me anë të zbatimit të sistemit matës My Avis. Me qëllim që të vlerësohet efekti i këtij projekti në konsumin e përgjithshëm, u vëzhguan dhe përpunuan të dhënat nga projekti i Durrësit. Ky vlerësim u krye duke krahasuar energjinë e blerë dhe të shitur si dhe të dhënat për humbjet për periudhën Maj - Qershor 2009 dhe Maj - Qershor 2010. Të dhënat tregojnë se niveli i humbjeve në periudhën Maj Qershor 2010 është 6.64% më i lartë se vitin e mëparshëm, gjë që nënkupton se, me qëllim që të arrihen targetet për reduktimin e humbjeve, konsumi i energjisë u rrit artificialisht me 6.64%. Me qëllim që të merret në konsideratë ky efekt në llogaritjen e konsumit të përgjithshëm të energjise elektrike për H2 2010, një koeficient CBSC = 0.9336 (llogaritur si 1 – 6,64%) u përdor në llogaritjet e parashikimit të konsumit për TU. Efekti i pastrimit të sistemit të faturimit nuk u përdor për TM, sepse ky efekt nuk është i konsiderueshëm në TM. Parashikohet që, deri në fund të vitit 2010, të gjitha kontratat fiktive do të eliminohen nga sistemi i faturimit e për rrjedhojë koeficienti i sipërpërmendur nuk u përdor për llogaritjen e konsumit për vitin 2011.

Duke marrë në konsideratë parimet e përmendura më sipër, formulat e përdorura për llogaritjen e konsumit të energjisë për H2 2010 mund të përshkruhen si në vijim:

$$\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TM H2 2010}} = \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TM H1 2009}} *$$

$$\left\{ 1 + \left(\frac{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TM H2 2009}}}{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TM H1 2009}}} - 1 \right) * 0.5 + \right.$$

$$\left. \frac{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TM H1 2010}}}{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TM H1 2009}}} - 1 \right\} * 0.02$$

$$2009 - 1 * 0.5 + \text{Nr.Skuadrave NTL} * \text{Targeti Mujor NTL} * 0.02$$

(6)

Rezultati i marre nga formula (6) u shpernda ndërmjet secilës kategori në TM, për H2 2010, sipas peshës specifike të konsumit të kategorive si në H1 2010.

Për konsumatorët familjarë dhe jo-familjarë në TU , u përdorën formulat si më poshtë:

$$\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{familjare H2 2010}} = \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{familjare H1 2009}} * C_{\text{BSC}} *$$

$$C_{\text{BSC}} *$$

$$\left\{ 1 + \left(\frac{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{familjare H2 2009}}}{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{familjare H1 2009}}} - 1 \right) * 0.5 + \left(\frac{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{familjare H1 2010}}}{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{familjare H1 2009}}} - 1 \right) * 0.5 \right\} + ((\text{Nr. Skuadrave NTL} * \text{Targeti Mujor NTL}) * 0.98) *$$

$$\frac{\text{Konsumi Familjare H1 2010}}{\text{Konsumi Total TU H1 2010}}$$

(7)

Rezultati i përftuar nga formula (7) u shpernda për secilën kategori në TU (familjarë) sipas peshës specifike të konsumit për bllokun e parë dhe të dytë të H1 2010. Duhet pasur parasysh që ecuri u llogarit veçmas për sa i përket kategorisë së familjarëve dhe jo-familjare .

$$\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{jofamiljare H2 2010}} = \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{jofamiljare H1 2009}} * C_{\text{BSC}} *$$

$$C_{\text{BSC}} *$$

$$\left\{ 1 + \left(\frac{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{jofamiljare H2 2009}}}{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{jofamiljare H1 2009}}} - 1 \right) * 0.5 + \right.$$

$$\left. \frac{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{jofamiljare H1 2010}}}{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{jofamiljare H1 2009}}} - 1 \right\} * 0.5 + \text{Nr. Skuadrave NTL} * \text{Targeti Mujor NTL} * 0.98 * \frac{\text{Konsumi JoFamiljare H1 2010}}{\text{Konsumi Total TU H1 2010}}$$

(8)

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 11 nga 80

Rezultati i përftuar nga formula (8) u shpernda për çdo kategori në TU (jo-familjare) sipas peshës specifike të konsumit të kategorive të konsumatorëve si në H1 2010

Të gjitha rezultatet e përftuara nga përdorimi i formulave (6), (7) dhe (8) dhe shperndarja ndërmjet çdo kategorie duke u bazuar në peshën specifike u përdorën për të ndërtuar bilancin e energjisë për TU dhe TM për H2 2010.

Për sa i përket tensionit të lartë TL, u përdorën dy metoda: njëra ishte llogaritja e bazuar mbi ecurine duke përdorur formulën si më poshtë:

$$\text{Konsumi Total i Energjise}_{TL H2 2010} = \text{Konsumi Total i Energjise}_{TL H1 2009} * \left\{ 1 + \frac{\text{Konsumi Total i Energjise}_{TL H2 2009} - \text{Konsumi Total i Energjise}_{TL H1 2009}}{\text{Konsumi Total i Energjise}_{TL H1 2009}} * 0.5 + \frac{\text{Konsumi Total i Energjise}_{TL H1 2010} - \text{Konsumi Total i Energjise}_{TL H1 2009}}{\text{Konsumi Total i Energjise}_{TL H1 2009}} * 0.5 \right\}$$

(9)

Rezultati i përftuar nga formula (9) u shpernda për çdo kategori në TL sipas peshës specifike të konsumit të kategorive si në H1 2010

Metoda tjetër e përdorur është konsumi i pritshëm i raportuar nga konsumatori Kurum për H2 2010 dhe 2011.

Si përfundim, konsumi i përgjithshëm i parashikuar për 2010 u llogarit si një shumë e H2 2010 dhe H1 2010.

Së katërti – për 2011, ne llogaritje u perfshi dhe efektit i pastrimit të sistemit të faturimit (përdorimi i sistemit matës My Avis) edhe për konsumin në TU për H1 2010. Kjo do të thotë se për llogaritjet e trendeve ndërmjet viteve 2009 dhe 2010, u pastrua dhe pjesa e parë e vitit 2010 nga faturimi fiktv për të arritur konsumin e një viti të plotë të pastruar nga efekti i faturimit fiktv. Viti baze për TU (viti 2010) është llogaritur si konsum i parashikuar H2 2010 + H1 2010 *CBCS. Në këtë mënyrë, është llogaritur viti total i pastruar 2010 për TU. Më poshtë

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 12 nga 80

gjeniformulat e përdorura për llogaritjet në TU (familjarë & jo-familjarë – me të njëjtin parim si për H2 2010), TM dhe TL me dy metoda.

$$\begin{aligned} \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{familjare 2011}} = & \\ \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{familjare 2010}} * \left\{ 1 + \left(\frac{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{familjare 2010}}}{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{familjare 2009}}} - 1 \right) \right\} + & \\ ((\text{Nr. Skuadrave NTL} * \text{Targeti Mujor NTL}) * 0.98) * \frac{\text{Konsumi Familjare 2010}}{\text{Konsumi Total TU 2010}} & \end{aligned} \quad (10)$$

$$\begin{aligned} \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{jofamiljare 2011}} = \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{jofamiljare 2010}} * \left\{ 1 + \right. & \\ \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{jofamiljare 2010}} \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{jofamiljare}} & \\ \text{2009-1} + \text{Nr. Skuadrave NTL} * \text{Targeti Mujor NTL} * 0.98 * \text{Konsumi JoFamiljare} & \\ \text{2010} \text{Konsumi Total TU 2010} & \end{aligned} \quad (11)$$

$$\begin{aligned} \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TM 2011}} = \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TM 2010}} * & \\ \left\{ 1 + \left(\frac{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TM 2010}}}{\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TM 2009}}} - 1 \right) \right\} + (\text{Nr. Skuadrave NTL} * \text{Targeti Mujor NTL}) * & \\ 0.02 & \end{aligned} \quad (12)$$

$$\text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TL 2011}} = \text{Konsumi Total i Energjise}_{\text{TL 2010}} *$$

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

$$\left\{ 1 + \left(\frac{\text{Konsumi Total i Energjise}_{TL,2010}}{\text{Konsumi Total i Energjise}_{TL,2009}} - 1 \right) \right\}$$

(13)

Gjithashtu, ashtu si edhe për H2 2010, konsumi në TL për 2011 është llogaritur duke u bazuar në informacionin e marrë nga konsumatorët e mëdhenj në TL (KURUM). Siç u tha më sipër, alokimi i çdo kategorie është bërë duke u bazuar në peshën specifike të çdo kategorie si në 2010.

Element tjetër i bilancit të energjisë është gjithashtu kategoria e “Konsumi vetjak”. Me qëllim që të parashikohet konsumi për H2 2010, janë përdorur të dhënat për periudhën Janar 2009 – Qershor 2010. Për gjysmën e parë të 2010, konsumi vetjak i përgjithshëm i matur dhe ishte në nivelin 7,1 GWh. Pavarësisht përpjekjeve të shumta, ka akoma disa rajone që paraqesin vlerën zero në zerin konsum vetjak gjatë gjysmës së parë të vitit 2010. Menaxhimi i OSSH do të eliminojë këtë pasaktësi gjatë gjysmës së dytë të 2010. OSSH parashikon një nivel të konsumit vetjak për vitin 2011 në nivelin 14,5 GWh.

Theksojme se konsumi vetjak është pjesë e OPEX (shpenzimet operative). Energjia që është matur si konsum vetjak është blerje e brendshme nga divizioni i shitjes dhe e konsideruar si shpenzim operative. Divizioni i shitjeve e blen këtë energji mbi bazën e çmimit të FPSH. Nga ky këndvështrim, konsumi vetjak pasqyrohet veçmas në bilancin e energjisë dhe nuk përfshihen si konsum i konsumatorëve fundorë.

Së pesti – me qëllim ndertimin e bilancit të energjisë, është llogaritur konsumi i orëve të pikut për H2 2010 dhe 2011. Për këtë qëllim, u përdorën të dhënat e matjes dhe instalimit të matësve Converge. Për pjesën e parë të vitit 2010, ne kemi llogaritur shumën e konsumit të orëve të pikut për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, aty ku janë instaluar matës CONVERGE. Më pas, për çdo kategori kemi llogaritur normën specifike mesatare kundrejt totalit. Për parashikimin e gjysmës së dytë të 2010, kemi llogaritur konsumin pik për çdo muaj duke

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 14 nga 80

shumëzuar parashikimin për muajin paraardhës me normën mesatare specifike e llogaritur për çdo kategori korresponduese të konsumatorëve.

Për 2011, është përdorur ecuri e thjeshtë për të llogaritur konsumin pik të energjisë dhe aplikimi i një koeficienti saturimi duke u bazuar në supozimin se deri në fund të vitit 2011, të gjithë konsumatorët e mëdhenj do të furnizohen me matës Converge. Bazuar në rezultatet e marra, konsumi pik është alokuar ndaj kategorive të konsumatorëve sipas peshës specifike të konsumit të tyre të pikut kundrejt totalit.

Së gjashti – gjithashtu edhe skenarë të tjerë janë marrë në konsideratë për krijimin e bilancit të energjisë për 2011. Duke presupozuar se dy konsumatorë (të lidhur në 6 kV), pasi kanë marrë Statusin e Kilentit të Kualifikuar nga ERE, ata do të lidhen me operatorin e sistemit të transmetimit (OSSH do t'i humbasë ata përfundimisht). Këta klientë janë Fabrika e Cimentos – Krujë dhe Fabrika e Cimentos – Elbasan me një konsum të parashikuar prej 72,5 GWh në total.

Së shtati – OSSH do të propozojë perlllogaritjet e përshkuarara në pikën 7.5. Alokimi i humbjeve në transformatore tek zoteruesit e këtij aseti. Nga ky këndvështrim, bilanci i energjisë është korrigjuar për efekt të këtyre llogaritjeve me minus 5 GWh në vit.

2.1.2. Numri i konsumatorëve

Gjithashtu, është llogaritur edhe numri i pritshëm konsumatorëve, duke u bazuar në të dhënat e marra nga Divizioni i Shpërndarjes se nga fundi i 2011, edhe 37.500 konsumatorët të rinj do të lidhen me rrjetin tonë (25.000 gjatë vitit 2010 dhe 25.000/2 gjatë vitit 2011 – si efekt i lidhjes graduale gjatë vitit 2011). Nevojitet të përmendet se struktura e konsumatorin sipas peshës specifike sipas nivelit të tensionit konsiderohet e pandryshuar (konsumatorët në TU, kryesisht familjare përbëjnë edhe pjesën më të madhe të konsumatorëve); kjo vërehet edhe në lidhjet e reja që janë realizuar deri më tani. Si bazë për këtë llogaritje është përdorur numri i konsumatorëve dhe struktura e 2009 dhe lidhje e reja të pritshme janë alokuar duke u bazuar mbi peshën specifike të çdo kategorie për vitin 2009.

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 15 nga 80

2.1.3. Parashikimi i kërkesës për Energji për 2011

Bazuar në metodologjinë e përshkruar më sipër, parashikimi i bilancit të energjisë elektrike është llogaritur dhe ka rezultuar në shifrën 3 979 593 MWh për t'ju shpërndare klientëve tarifore dhe 4 139 593 MWh për t'iu shitur klientëve fundorë të OSSH.

Energjise ne shpërndarje i eshte shtuar dhe niveli i humbjet i pritshme në masen 27,92 %. Vlera e përgjithshme ne MWh e injektuar ne sistemin e shpërndarjes parashikohet 5 521 077 MWh.

Ne menyre te detajuar bilanci i pritshem i energjisë elektrike, duke përfshirë edhe numrin e klientëve, tregohet në **Shtojcën Nr. 1**

2.2. Norma me norma fiskaleme norma fiskalee

Taksa mbi të ardhurat e korporatës e përdorur në llogaritje të WACC është 10%.

2.3. CPI

CPI do të përcaktohet në bazë të inflacionit së dhënë nga Banka Kombëtare e Shqipërisë 3% duke marrë në konsideratë dokumentin e politikës monetare për 2009 – 2011 (burimi: www.bankofalbania.org).

2.4. Norma Kembimit Valutor

Parashikimi i normës se Kembimit Valutor bazohet mbi supozimet e departamentit të Financës dhe Thesarit të Zyrave Qendrore të CEZ në nivelin 135,30 Leke/EUR.

2.5. Humbjet dhe kostot e energjisë së importuar

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 16 nga 80

OSSH dëshiron të informojë ERE-n se, duke u bazuar në rezultatet e “Studimit të Humbjeve Teknike” dhe duke analizuar planin e reduktimit të humbjeve të kryer nga kompanie e pavarur e konsulencës PriceWaterhouseCoopers, e cila është përzgjedhur në përputhje me deklaratën rregullatore. Skenari i propozuar nga ERE në deklaratën rregullatore në seksionin 4.5 nuk na duket i përshtatshëm. Për rrjedhojë, duke u bazuar në deklaratën rregullatore, OSSH do të propozojë një program të ri për reduktimin e humbjeve, i cili do të përmbajë shpjegime dhe argumentime të detajuara në aplikime të veçanta. Në vijueshmëri të këtij propozimi, ne e bazojmë llogaritjen tonë në nivelin e ri të propozuar të humbjeve për 2011 në nivelin 27,92 % (në vend të 8% në raport me nivelin fillestar të humbjeve d.m.th 33,92% - ulja do të jetë minus 6% nga ky nivel). Propozimi i programit të ri do t'i dorëzohet ERE-s nga fundi i Shtatorit. Ekzistojnë disa arsye që shpjegojnë mospërshtatjen e skenarit të propozuar në deklaratën rregullatore, e cila shkakton vonesa në aspektet e punës së OSSH dhe sjell impakte financiare:

- Vonesa në procesin e blerjes dhe marrjes në administrim të kompanise (duke i shkaktuar OSSH vonesa prej 6 muajsh më shumë nga parashikimet)
- Situatë e vështirë financiare e OSSH me impakt mbi mundësitë për investime
- Ngrirje e negociatave me EBRD/IFC për shkak të konfliktit ndërmjet ERE dhe OSSH
- Pastrimin e bazës së të dhënave
- etj.

Sasia e parashikuar e humbjeve për vitin 2011 është 1 541 485 MWh.

Çmimet e supozuara bazohen në pritshmëritë e tregut të departamentit të CEZ group Trading për rajonin e Ballkanit me fokus në Shqipëri në nivelin 51,9 EUR/MWh plus 1,5 EUR/MWh për kapacitetin ndërkuftar – çmimi i blerjes i përdorur në aplikimin e tarifës është 53,4 EUR/MWh.

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 17 nga 80

OSSH është në pritje të hapjes së tenderit për importet e energjisë së 2011 brenda periudhës Tetor – Nëntor 2010 me qëllim që të arrijë në llogaritjen përfundimtare. Rrjedhimisht, çmimi përfundimtar i blerjes i përdorur në llogaritje mund të ndryshojë në varësi të rezultateve të tenderit.

2.6. Çmimi i FPSH dhe TSO

OSSH parashikon në këtë përlllogaritje çmimi se tarifat e FPSH dhe OST do të mbeten të pandryshuara në krahasim me vitin 2010 – pra 2 030 Leke/MWh për FPSH dhe 600 Leke/MWh për OST.

3. OPEX (SHPENZIMET OPERATIVE)

3.1. Ristrukturimi i kompanisë dhe koncepti i Shërbimeve të Përbashkëta

Pas blerjes nga CEZ sh.a në mesin e vitit 2009, OSSH po kalon një proces ristrukturimi të plotë organizative dhe ri-projektimi të proceseve. Këto ndryshime janë ndërmarrë nga nevojja për të ndryshuar strukturën organizative ekzistuese dhe projektimin e procesit në vend, në periudhën e marrjes në dorëzim të kompanisë.

Në të kaluarën, kompania ka qenë organizuar në zona gjeografike të quajtura “Zona”. Brenda Zonave, organizimi i Shpërndarjes, Shitjeve dhe Proceseve të Suportit ishin implementuar ndryshe nga njëra zonë në tjetrën. Në shumicën e rasteve, punonjësit nuk ishin përcaktuar siç duhet në departamentet e duhura, e cila do të mund të identifikonte pjesën e procesit të kompanisë. Shpesh punonjësit ishin caktuar në departamente që nuk korrespondojnë fare me profilin e tyre të punës dhe me detyrat që duhet të kryenin. Në shumicën e rasteve, punonjësit kanë pasur funksione të shumta në profilin e tyre të punës, të cilat ndërthureshin me funksione të veprimtarisë së Shpërndarjes, Shitjeve dhe/ ose funksioneve të Mbeshtetjes , siç janë Logjistika, Financa etj.

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 18 nga 80

Një strukturë e tillë nuk ishte e përshtatshme për ndarjen e shpenzimeve operative, nga ajo që do të kërkohet për shpenzimet operative në ndahen në Divizionin e Shpërndarjes dhe Furnizimit në të ardhmen, si dhe ky lloj strukturimi nuk mbeshteste alokimin korrekt të kostove në funksionet përkatëse.

Për më tepër, një strukturë e tillë nuk shfrytëzonte përfitimet e centralizimit të proceseve dhe rrjedhja e informacionit nuk ishte e sigurt. Si rrjedhim, për aplikimin e tarifës për vitin 2010, e paraqitur tek ERE në Shtator të vitit 2009, ndarja ndërmjet OSSH dhe shpenzimeve të FPP, u propozua dhe miratua mbi baza të vlerësuara, si ndarja e kostove në proporcionin prej 90% në DSO dhe prej 10% të FPP.

Bazuar nga sa më sipër, menaxhimi i ri i OSSH-së, ka vendosur që gradualisht të zbatojë “praktikat më të mira”, të cilat janë të vërtetuara nga filialet e tjera të CEZ-it në Republikën Çeke si dhe në vendet e tjera. Vendosja e këtij standarti dhe krahasimi me aktorët e tjerë shumëkombësh në fushën e shpërndarjes së energjisë është siguruar duke kontraktuar konsulentë të jashtëm me eksperiencë të gjerë, në projekte të ngjashme brenda sektorit të energjisë.

Ndryshimi i organizimit është sinkronizuar në disa hapa brenda vitit 2010. Pikë së pari, ndryshimi i linjës së raportimit të menaxhimit në zyrat qendrore në Tiranë, ka filluar me zbatimin e organizimit të matricës. Me pas, është kryer alokimi i saktë i stafit për funksionet përkatëse. Bazuar në këtë alokim, ka pasur shumë zhvendosje punonjësish midis departamenteve, brenda periudhës së gjysmës së parë të vitit 2010. Organizimi dhe proceset përfundimtare janë planifikuar të zbatohen më 1 Tetor, 2010. Pas asaj date, organizimi i OSSH-së do të zbatohet siç është paraqitur në tabelën organizative si më poshte:

Aplikimi i tarifave për vitin 2011


OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 19 nga 80



TARGET ORGANIZATION OF OSSH AS OF OCTOBER 1st, 2010

OSSH Organization Structure as at 1st October



1

Fig. Struktura organizative e ardhshme e OSSH që nga 1 tetori 2010

CEZ dhe OSSH do të vazhdojë më tej me zbatimin e konceptit të Shërbimeve të Përbashkëta (Shared Services) në Shqipëri, për vetë faktin se ky koncept u vërtetua si praktika më e mirë, jo vetëm brenda grupit të CEZ-it por edhe në kompanitë më të fuqishme në Evropë. Parimi kryesor i konceptit është eliminimi i dublikimeve në proceset jo thelbësore brenda kompanive të të njëjtit grup. Në këtë mënyrë, bëhet i mundur zbatimi i strukturave më efektive të kostove. Gjithashtu, ky koncept mbështet ndarjen e funksioneve të Shpërndarjes dhe FPP në OSSH në të ardhmen, meqë proceset mbështetëse janë tashmë siguruar mbi bazat e marrëveshjes në nivel shërbimi (SLA) nga një ent i vecantë ligjor, dhe si rrjedhim ndarja e tyre është më e lehtë dhe më e shpejtë. Parimet kryesor të këtij koncepti janë të përshkruara në figurën e mëposhtme:

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 20 nga 80



Ka disa përfitime nga zbatimi i konceptit të Shërbimeve të Përbashkëta. Siç është përmendur deri tani, koncepti mbështet zbatimin e Legjislacionit Evropian për paketën e dytë dhe të tretë të ndarjes së proceseve (unbundling package).

Shërbimet e Përbashkëta (FSS) gjithashtu sigurojnë përfitime mbi centralizimin e proceseve ndihmëse dhe në këtë mënyrë sjellin përfitime nëpërmjet “ekonomisë së shkallës”, si për shembull mundësitë për të standardizuar dhe automatizuar proceset, përdorimin e përbashkët të mjeteve, ambienteve të ndërmarrjeve, infrastrukturës, duke ndarë kështu kostot e tyre. Një shembull mund të jetë ndarja e infrastrukturës së IS&IT, duke përfshirë reduktimin e fuqisë punonjese, sigurimin, dhe aktivitetet ndihmëse, të cilat janë shumë të kushtueshme nëse zbatohen veçmas secila. Në këtë rast, OSSH shfrytëzon infrastrukturën e krijuar nga Grupi CEZ në Republikën e Çekës nëpërmjet lidhjeve/komunikimit në distancë. Në këtë mënyrë, OSSH

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 21 nga 80


ka të drejtën e një zgjidhjeje “bashke kohore ” me standardet e sigurisë më të lartë dhe pa kërkesa shtesë të CAPEX (Shpenzimet Kapitale), të cilat do të reduktonin fondet e disponueshme për t’u përdorur për përmirësimin e rrjetit. Gjithashtu, centralizimi i proceseve redukton kostot për trajnimin e stafit dhe lehtëson zbatimin e ndryshimeve në procese. Si shembull te këtij thjeshtësimi mund të sjellim zbatimin e sistemeve të reja, ku në vend që të transferojnë njohuri teknike njësisive të ndara, janë krijuar ekipet e centralizuara, të cilat përbëhen nga punonjës shumë të kualifikuar,. Pra, kjo fazë sjell perspektiva më të mëdha dhe më të mira për efikasitetin e proceseve dhe praktikave të vendosura, si dhe potencialisht përmirësime dhe ndryshime të mëdha në të ardhmen.

Ekipet e centralizuara, gjithashtu sigurojnë perspektivë më të madhe në kontrollin dhe mbështetjen e ekipit të menaxhimit duke pasur mundësi hyrjeje në të dhënat e kompanisë elektronikisht dhe në kohën e duhur. si shembull te një përmirësimi të efikasitetit mund të sjellim mbylljen e llogarive të kontabilitetit në fund të vitit dhe përgatitja e pasqyrave financiare, të cilët sipas standardeve të grupit, duhet të kryhen brenda 15 ditëve të Janarit, ndërkohë në të kaluarën procesi zgjaste për muaj të tërë.

CEZ gjithashtu po përpiqet të zbatojë modelin standard dhe në Shqipëri. Këta parime thelbësore janë të paraqitura në figurën si më poshtë:



FOR OSSH, CEZ INTENDS TO USE THE STANDARD MODEL FOR FOREIGN ACQUISITIONS




Qendrat e Kostove për Shërbimet të Përbashkëta janë duke u përcaktuar në mënyrë sa më transparente nga kompanitë brenda grupit, duke u bazuar në politikat e çmimit të transferimit, të cilat janë konfirmuar nga studimet e cmimeve të transferimit kryera nga institucione dhe auditorë të pavarur. Gjithashtu, çmimi i transferimit është rregulluar nga rregullat e OECD dhe grupi i CEZ-it është shumë i kujdesshem në zbatimin e këtyre rregullave. Ka dy modele kryesore të kostimit për përcaktimin e çmimit të Shërbimeve të Përbashkëta. Modeli i parë është “kost plus” e cila është bazuar në alokimin e kostos së saktë për aktivitetet e ndara duke përfshirë dhe alokimin e kostove të përgjithshme fikse dhe pastaj duke shtuar marzhin e fitimit të caktuar nga auditori i pavarur në studimin për çmimin transferues sipas tregut aktual. Modeli i dytë i kostimit bazohet në standardet e tregut për shërbime të ngjashme, të cilat janë të përcaktuara në studimin për çmimin e transferimit. Aktualisht CEZ po përdor të dyja modelet. Modeli i parë përdoret për shumicën e aktiviteteve duke përfshirë rishitjen e materialeve, kostot

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

e punes per stafin lokal, marrjet me qera si dhe kosto të tjera operative. Modeli tjetër është përdorur kryesisht për shërbimet e keshillimit të siguruara nga CEZ, s.a, shërbime kryesisht të siguruara nga personeli huaj, i ardhur ne Shqipëri. Parimet kryesore të dy modeleve të kostimit janë paraqitur më poshtë:



Bazuar në strukturën organizative të planifikuar, buxheti i Shpenzimeve Operative për vitin 2011, është përgatitur sipas katër divizioneve kryesore – Shpërndarjes, Shitjes, Financës dhe Administrimit të Përgjithshëm. Alokimi i kostove të Administrimit të Përgjithshëm dhe të Financës për veprimtarinë e Shpërndarjes dhe Furnizimit me Pakice, është bazuar në faktorin e alokimit sipas numrit të punonjësve në Shpërndarje dhe në qendrat përkatëse të kostove në FPP.

Megjithatë, organizimi i zbatuar nuk e mbështet drejtpërdrejt alokimin e kostove sipas niveleve të ndryshme të tensionit, sepse stafi dhe burimet janë të perbashketa brenda niveleve të ndryshme të tensioneve, dhe ndarja e tyre do të rrisë menjëherë numrin e punonjësve që nevojiten, dhe për rrjedhojë dhe shpenzimet operative. E vetmja mundësi që kostot të alokohen direkt sipas niveleve të ndryshme të tensionit është alokimi i aktiviteteve të teknikëve sipas pasqyrës së kohës së punës që ata kryejnë në nivelet e ndryshme të tensionit. Ky është plani për të ardhmen në përputhje me zbatimin e funksioneve shtesë të sistemit ERP. Ndërkohë, alokimi i kostove sipas niveleve të tensionit duhet të mbështetet në supozime dhe faktore alokimi. .

Bazuar në përshkrimin e mesipër të situatës, është e qartë që krahasimi ndërmjet viteve për ndarjen e kostos të Shpërndarjes dhe Furnizimit me Pakicë, mund të jenë i pa rregullt, prandaj ne do të ofrojmë në kapitujt që vijojnë krahasimin vetëm në nivel total -së për grupet përkatëse të OPEX-it të OSSH.

3.2. Kostot e Personelit

Zhvillimi në zërit të kostove të personelit të OSSH-së, në njërin anë pasqyron reduktimin e numrit të punonjësve dhe, në anën tjetër “përmirësimin i aftësive”. Përmirësimi i aftësive nënkupton zëvendësimin e stafit me performancë të ulët ose edhe të punonjësve me sjellje në kundërshtim me etikën e punës në kompani. Pjesë të rëndësishme të kostos së parashikuar për vitin 2011 janë përcaktuar për të ndryshuar skemën e motivimit për punonjësit me qëllim që të përmirësojnë më shumë efikasitetin e kompanisë dhe të sigurojnë përfshirjen e punonjësve lokalë në menaxhimin e kompanisë, si dhe interesin e tyre në rezultatet e kompanisë dhe cilësisë së shërbimit të ofruar tek konsumatorët fundorë. Një pasqyre e zhvillimit të kësaj kostoje është paraqitur në **Shtojcën Nr.2**

3.3. OPEX TE TJERA - SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

Shpenzimet e tjera operative përbëhen nga dy grupe kryesore të kostove. Grupi i parë merret direkt me materialet dhe shërbimet e kontraktuara nga OSSH si për shembull: marrjet me qira, mirëmbajtje, materiale, udhëtimi etj. Grupi i dytë merret me shërbimet e siguruara nga Qendra e Shërbimeve të Përbashkëta, siç është përshkruar si më sipër në paragrafin 3.1.

Shpenzimet operative të parashikuara për vitin 2011, do të ndjekin hapat e strukturës së kostove të miratuara dhe të modelit të vitit 2010, por me disa ndryshime të vogla që do të jenë të shpjeguara si më poshtë:

E para – Shpenzimet e qerave po rriten për shkak të disa arsyeve.

Së pari, kompania ka hyrë në marrëveshje qeraje për magazinat e reja në përputhje me konceptin e ri të Logjistikës, atë të centralizimit të magazinave dhe zëvendësimit të magazinave aktuale pa mjete sigurie. Në shumicën e rasteve vendet aktuale (te marra me qera), jo vetëm që nuk ishin në një gjendje që të plotesonin standardet, por ishin edhe shkak i mashtrimeve me materialet e kompanisë, sjellje keto që shkaktonin jo vetëm kosto të pakontrollueshme por gjithashtu, ulnin cilësinë e shpërndarjes duke dërguar materiale të vjetra në vend të atyre të reja.

Së dyti, menaxhimi i kompanisë vendosi të konsolidojë administrimin e kompanisë, e cila solli ndryshimin e vendndodhjes së zyrave aktuale, si dhe centralizimin e disa funksioneve në Tiranë. Për këtë qëllim, kompania ka marrë me qera zyra të reja me më shumë hapësirë. Përveç kësaj, për disa nga ambjentet e përdorura më parë nga OSSH pa pagese, është lidhur kontrata e qerave.

Së treti, menaxhimi i OSSH-së, në vend që të perdore CAPEX-in e kufizuar për të blerë makina të reja, vendosi të zbatojë ecurine normale të sigurimit të automjeteve të kompanisë; pra, menaxhimi praktikoi ose zbatoi marrjet me qera të automjeteve. Brenda vitit 2010 janë marrë dhe akoma do të merren me qera një numër i konsiderueshëm automjeteve për aktivitetin e ekipeve të krijuara për identifikimin e NTL (humbjeve jo- teknike), si dhe të ekipit të Arkëtimit, me qëllim sigurimin e zmbeshtetjes së aktiviteteve të tyre. Gjithashtu, në

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 26 nga 80

divizionin e Shpërndarjes ka filluar zëvendësimi gradual i automjeteve, të cilat ishin në gjendje të shkatërruar. Dhe ky aktivitet do të vazhdoje dhe në vitin 2011.

Ne ndryshim nga rritja e lehte e kostove, OSSH parashikon një ulje të kostove për materiale dhe mirëmbajtje krahasuar me vitin 2010.

Së dyti – grupi i dytë i Shpenzimeve të tjera Operative, siç u tha me sipër, janë kostot e kontraktuara nga OSSH me qendrën e Shërbimeve të Përbashkëta. Ne parashikojmë kostot në përputhje me nivelet e tyre të miratuara për vitin 2010 por me disa ndryshime të cilat do të shpjegohen si më poshtë:

Kostot e personelit qendrës së Shërbimeve të Përbashkëta janë ndikuar nga rritja e pritshme e niveleve të pagës të stafit aktual, nga centralizimi i metejshëm i funksioneve të OSSH në Qendrën e Shërbimeve të Përbashkëta. Këto do të jenë departamenti i IS & IT, si dhe stafi i Logjistikës, sipas konceptit të centralizimit të tyre të prezantuar më lart. Për më tepër, baza për krahasimin e vitit 2010 dhe 2011 nuk të orienton, pasi stafi i Qendrës së Shërbimeve të Përbashkëta është marrë në punë gradualisht gjatë vitit 2010 dhe në këtë mënyrë kostot e vitit 2010 nuk pasqyrojnë vlerën vjetoretë plotë ndërkohë, në vitin 2011 ne do të kemi të krijuar stafin e plotë.

treguesi i dytë për rritjen e kostove është kostoja e zbatimit të sistemit të kontabilitetit të ri dhe të sistemit ERP përfshirë përmirësimin e tij duke futur modulën e Menaxhimit të Materialeve brenda vitit 2010, e cila do të sigurojë menaxhimin e përshtatshëm të kërkesës për blerje për materiale, dorëzimin e tyre dhe mënyrën e miratimit, si dhe do të zbatojë kontroll të plotë në aktivitetet e prokurimit të kompanisë. Gjithashtu, do të sjellë më tepër përmirësime në disa procese financiare, kryesisht në atë të Thesarit, ku sistemi i kontrollit dhe miratimit të pagesës do të kryhet me transferatë të automatizuara ndërmjet kompanisë dhe bankave. Gjithashtu, do të sigurojë mundësimë të mira për të menaxhuar dhe parashikuar “cash flow” të kompanisë. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, funksionet që mbulojnë menaxhimin e

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 27 nga 80

programeve të investimit janë duke u zbatuar me qëllim që të sigurojnë kontroll të plotë në projektet e investimeve, gjendjen e tyre si dhe kontrollin e kostove kundrejt buxhetit të miratuar. Për më tepër, do të lejojë parashikime më të mira të “cash flow” për investime, të rritjes së bazës së aseteve dhe amortizimit të saj.

Së treti, buxheti i vitit 2011 për shpenzimet e IS&IT, do të mbulojë kostot e veprimtarisë së krijimit të infrastrukturës CONVERGE, e cila përbëhet nga servera dhe baza të dhenash, si dhe do të merret me mirëmbajtjen e tyre, “backup”, sigurimin etj. Kjo infrastrukture do të përdoret për perpunimin e të dhenave nga matës të instaluar tek klientet. Të dhenat me pas analizohen dhe përgatiten për tu importuar në sistemin e faturimit në OSSH.

3.4. Përmbledhje totale e Shpenzimeve Operative (OPEX).

Përmbledhja totale e Shpenzimeve Operative dhe alokimi i tyre për Shpërndarjen dhe Furnizimin me Pakice, si dhe ndarja e kostove të Shërbimeve të Përbashkëta janë të paraqitura në **Shtojcën nr. 3**

4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

4.1. SHPENZIMET OPERATIVE (OPEX)

4.1.1. Parimet e alokimit

Alokimi i kostove për OSSH bëhet në dy hapa. Së pari, kostot e personelit janë llogaritur duke u bazuar në strukturën organizative të parashikuar, e cila do të hyjë në fuqi nga 1 Tetori 2010. Në këtë mënyrë, kostot e të gjithë vitit 2011 janë llogaritur drejtpërdrejt vetëm për OSSH. Së dyti, shpenzimet e tjera operative të organizimit janë alokuar sipas qendrave të kostove të bazuara në përdorimin e supozuar të kostove të duhura. Së treti, kostot e divizioneve të Administratës të

Përgjithshme dhe Financës janë alokuar ndaj Shpërndarjes dhe FPP, duke përdorur faktorin e alokimit të llogaritur sipas numrit të punonjësve në qendrat e kostove në Shpërndarje dhe FPP.

4.1.2. Parashikimi i shpenzimeve operative - OPEX – për vitin 2011

Si rezultat i metodologjisë së shpenzimeve të përmendur më sipër, totali i OPEX të OSSH i përdorur për qëllime të llogaritjes së tarifës është 6 696 686 mijë Leke.

4.2. SHPENZIMET KAPITALE (CAPEX).

Vlerat e investimeve të llogaritura në tarifë janë bazuar në planet e investimit për 2010 dhe 2011, të cilat ndjekin Strategjinë e Investimit të OSSH dhe janë përgatitur e aprovuar në bashkërendim me specialistëve lokalë të shpërndarjes nga CEZ group dhe konsulentët e jashtëm. Strategjia e Investimit e përcakton këtë qasje në katër segmente: - secili nga nivelet e tensionit dhe matjes. Përveç investimeve në rrjet, planet e investimit përfshijnë përmirësime të nevojshme në fusha mbështetëse si: sistemet e informacionit, logjistika etj.

Siç u përmend më sipër, Strategjia e Investimit fokusohet në katër segmente të shpërndarjes dhe përcakton prioritetet dhe qasje për secilin prej tyre. Parimet ndiqen me një akollim të kujdesshëm të fondeve të kufizuara të disponueshme në fushat perkatese dhe me një përzgjedhje të projekteve të përshtatshëm. Fokus kryesor i vihet reduktimit të humbjeve në rrjet.

Strategjia për rrjetin e tensionit të lartë përcakton prioritetet të transformimit të 110 kV / TM në vend të transformimit të tanishëm 35 kV -> TM. Megjithatë, tensioni i lartë kërkon një sasi domethënëse fondesh të investimeve për shkak të marrjes së detyrueshme të nënstacioneve nga KESH – të planifikuara për t'u kapitalizuar në tremujorin e katert 2010. Zëvendësimi i planifikuar i katër transformatorëve të vjetruar 110 / TM në 2011 do të kontribuojë pozitivisht në reduktimin e humbjeve.

Strategjia e investimit në tensionin e mesëm përcakton prioritetet në përmirësimin gradual të kushteve teknike me fokus të vecantë mbi fushat me konsumatorë të rinj. Njësimi (unifikimi) i

rrjetit 20 kV si një zgjidhje e synuar do të ketë përparësi përkundjet fiderave aktualë të gjatë, duke synuar përmirësimin në sigurinë e furnizimit, si edhe targetimin e uljes së humbjeve. Deri në fund të vitit 2011, ne planifikojnë të zëvendësojme më shumë se 350 transformatorë të shpërndarjes.

Rrjeti i tensionit të ulët është përcaktuar me prioritet të lartë për shkak se është kontribuesi më i madh ndaj humbjeve të të dy llojeve teknike dhe jo-teknike. Për më tepër, statusi i rrjetit nuk mbështet në shumë raste matjen e duhur, si edhe instalimin e matësve të rinj të pikave të prodhimit për shkak të nën-tensionit të shpeshtë nominal. Pjesa domethënëse e rrjetit është akoma duke përdorur linja ajrore të pa-izoluara, të cilat janë shpesh subjekte të lidhjeve të paligjshme dhe në këtë mënyrë rritet niveli i humbjeve. Rrjedhimisht, strategjia thekson përdorimin e linjave të reja, si edhe zëvendësimin e linjave ekzistuese. Mundësia për përdorimin e kabllave nëntokësorë do të vlerësohet në mënyrë të kujdesshme për çdo projekt, veçanërisht për zonat urbane.

Pika e katërt e rëndësishme e strategjisë së investimit fokusohet mbi Matjen në të gjitha nivelet e tensionit, duke përfshirë pikat e dorëzimit me OST. Plani i investimit nuk parashikon vetëm instalimin e matësve, por gjithashtu edhe plotësimin e procesit të matjes. Dy projektet kryesore në këtë fushë janë CONVERGE dhe My Avis: i pari synon leximin e vazhdueshëm të pikave të dorëzimit dhe konsumatorët e mëdhenj, ndërsa i dyti synon procesin e automatizuar të të dhënave të madhes së konsumatorëve të vegjël – të përfshirë në kategorinë familjare.

4.2.1. Parashikimi i CAPEX për 2010

Plani i investimit i aprovuar nga ERE për 2010 në shumën prej 4,3 miliardë lekë nga fundi i 2009 është zbatuar gjatë gjysmës së parë të vitit. Ky është rishikuar periodikisht dhe është përditësuar me informacione të reja të disponueshme. Ndikim domethënës mbi realizimin brenda gjysmës së parë të vitit ka pasur fakti se OSSH nuk ka qenë në gjendje të marrë kredi afatgjata, sepse negociatat me EBRD dhe IFC janë ngrirë për disa muaj ngaqë institucionet

financiare kanë qenë në pritje të zgjidhje së konfliktit ndërmjet OSSH dhe ERE për tarifat e 2010. Prandaj, plani është ripunuar duke pasur synim të ruajë të pandryshuar nivelin e investimit sa më shumë që të jetë e mundur. Për më tepër, trysnia e KESH mbi OSSH në lidhje me përmbushjen e detyrimeve kontraktuese dhe marrja e nënstacioneve të ndërtuara nga ata është shtuar gjatë gjithë vitit. Vlerësimi ynë i tanishëm ka të bëjë me faktin se kapitalizmi total i aseteve brenda 2010 do të arrijë nivelin e 4,54 miliardë lekë më një ndarje të pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Pershkrimi	Klasa	Investimet deri ne fund te vitit bazuar ne perditesimin e PI ne 9.8.2010
Toka me Ndertesa	3120	
Toka & Permiresim toke	3110	
Ndertesa Teknike	2110	
Ndertime	2120	2,059,634,979
Makineri dhe Pajisje te tjera	2230	126,368,119
Transformatore	2230	
Linja ajrore(TL)	2230	1,023,836,502
Linja ajrore(TM)	2230	
Dispeceria dhe kontr.sistemit	2230	
Linja nentokesore (TM)	2230	
Sistemi i Matjes	2240	1,126,827,037
Pajisje pune te renda	2260	
Furnitura dhe instalime	2910	124,400,000
Pajisje kompjuterike	2251	75,445,608
Pajisje te teknologjise informatike	2250	3,754,392
TOTALI		4,540,266,637

Tabelë. Parashikimi i investimit për 2010

4.2.2. Parashikimi i CAPEX për 2011

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 31 nga 80

Plani i investimit për 2011 do të dorëzohet në ERE, sipas procedurave të vecanta, me përshkrime të detajuara të projekteve perkateseperkatese. Në këtë mënyrë, ne do të ofrojmë informacione paraprake mbi nivelin e përgjithshëm dhe ndarjen sipas grupeve perkateseperkatese të aseteve, të cilat janë përdorur për llogaritjen e Bazës Rregullatore të Aseteve, si edhe për llogaritjen e Amortizimit. Këto shifra janë objekt i procesit në vijim për miratim nga Komiteti Qendror i Investimeve në OSSH. Niveli i përgjithshëm i investimeve për 2011 parashikohet në shumën 4.9 miliardë lekë. Ky nivel përfaqëson një rritje prej 13 % përkundrejt vlerës së miratuar nga ERE për 2010. Kjo gjë thekson përkushtimin dhe përpjekjet e CEZ & OSSH për të zhvilluar dhe përmirësuar rrjetin në Shqipëri.

Plani i investimit për 2011 ndjek strategjinë e investimit të përshkruar më sipër. Pikat themeltare të investimit janë si më poshtë:

- Instalimi dhe/ose zëvendësimi i matësve të energjisë për të gjithë konsumatorët. Ne jemi duke parashikuar të marrim masa për zëvendësimin e të gjithë matësve, të cilët kanë probleme teknike. Gjithashtu, ne do të plotësojmë të gjitha kërkesat e konsumatorëve potencialë që do të kryejnë lidhje vitin tjetër. Puna që do të kryhet, përfshin instalimin e 25,000 matësve të rinj në lidhje të reja. Zëvendësimi i matësve ekzistues me të rinj dhe zëvendësimi i të gjithë matësve me probleme teknike do të kapë shifrën 90,000.
- Instalimi i elektro-matësve me lexim të vazhdueshëm për klientët e mëdhenj në kuadër të projektit Converge, projekt që ka filluar të zbatohet suksesshëm në vitin 2010. Puna që do të kryhet, përfshin instalimin e rreth 5000 matësve të rinj, si edhe instalimin e 130 matësve të rinj në pikat e ndërveprimit me OST.
- Shtrirje progresive e linjave 20 kV në zonat kryesore urbane. Shtrirja e sistemeve 20 kV do të bëhet me qëllim që të ulet humbjet dhe të furnizohet klientët e rinj. Një gjatësi totale prej 60 km të linjave TM dhe ndërtimi/rindërtimi i rreth 250 TM/TU kabinave parashikohet të zbatohet. Në zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes 20 kV në qytetet

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 32 nga 80

kryesore merret në konsideratë edhe përqendrimi i kërkesës dhe fakti se seksioni TM/TU i rrjetit ndikon për shumicën e humbjeve brenda rrjetit të shpërndarjes.

- Ndërtimi i rrjetit me tension te ulet TL me linja ABC në zonat kryesore urbane, veçanërisht në periferi. Kjo bëhet me qëllim që të reduktohen edhe më tej humbjet jo-teknike. Më 2011, Plani i Investimit parashikon të ndërtoje rrjetin TU me linja ABC në një gjatësi të përgjithshme prej 330 km; ky rrjet do të furnizojë rreth 30000 konsumatorë. Zhvillimi i këtij rrjeti siç është përmendur edhe më sipër do të kryhet në zonat kryesore urbane, veçanërisht në periferitë e atyre qyteteve ky konsumatorët janë zhvendosur nga zonat rurale dhe kushtet teknike të rrjetit ekzistues nuk përmbushin standardet teknike, duke sjellë nivel të lartë të humbjeve teknike, si edhe nivel të lartë të vjedhjes së energjisë.
- Rindërtimi i nën-stacioneve ekzistuese, veçanërisht në TU/TM me qëllim që të rritet qëndrueshmëria e sistemit dhe të përgatitet për zhvillime të ardhshme. Këto ndërtime do të kryhen duke përdorur pajisje 20 kV, pavarësisht se mund të operohen në fillim me 6 kV dhe/ose 10 kV derisa pjesa perkatese e rrjetit do të jetë e gatshme për t'u azhurnuar.
- Përmirësim i leximit të energjisë në kuadër të projektit My Avis. Ky projekt parashikon blerjen e PDA-ve të reja për të pajisur të gjithë lexuesit dhe të mundësojë lexim të saktë të matësve, duke kontribuar në reduktimin e humbjeve jo-teknike.

Ndarja e aseteve në klasa për CAPEX për vitin 2011 pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 33 nga 80

Pershkrimi	Klasa	SHTESAT 2011
Toka me Ndertesa	3120	
Toka & Permiresim toke	3110	
Ndertesa Teknike	2110	
Ndertime	2120	
Makineri dhe Pajisje te tjera	2230	491,879,058
Transformatore	2230	259,997,226
Linja ajrore(TL)	2230	1,260,110,362
Linja ajrore(TM)	2230	1,185,686,504
Dispeceria dhe kontr.sistemit	2230	
Linja nentokesore (TM)	2230	
Sistemi i Matjes	2240	1,381,238,850
Pajisje pune te renda	2260	
Furnitura dhe instalime	2910	265,000,000
Pajisje kompjuterike	2251	52,088,000
Pajisje te teknologjise informatike	2250	
TOTALI		4,896,000,000

Fig. Ndarja e planit të investimit për 2011

4.3. Amortizimi

Duke u bazuar në negociatat me përfaqësuesit e ERE-s, ne do të dëshironim të sugjeronim një qasje të re në lidhje me llogaritjen e amortizimit për aplikimin e tarifës.

Qasja e re rrjedh nga një ndarje logjike e asetëve në dy grupe. Një grup përbëhet nga asetet e blera përpara privatizimit (të gjitha asetet deri më 31.5.2009) – “asetet e vjetra”; grupi i dytë përbëhet nga asetet kapitalizuara pas privatizimit (nga 1.6.2009 dhe në vijim) – “asetet e reja”.

Amortizimi i asetëve të vjetruara është llogaritur duke u bazuar në jetëgjatësinë e mbetur e përdorimit – RUL (remaining useful life) e aplikuar ndaj klasës perkatese të asetëve. Për llogaritjen e kohës e mbetur të përdorimit – RUL – të çdo klase të asetëve është përdorur regjistri i pronave të patundshme që nga dita e mbylljes së privatizimit (31.5.2009). Mesatarja është llogaritur duke u bazuar në të gjitha asetet në klasës perkatese të asetëve që kanë datën e

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 34 nga 80

disponueshme të kapitalizmit. Për sa i përket elektro-matësve – si pjesë e asetëve të vjetra, asnjë datë kapitalizmi nuk është e disponueshme dhe për pasojë, vlerësimi i ekspertëve është mbështetur në këtë klasë të asetëve. Formula për përcaktimin e jetëgjatësisë së mbetur të përdorimit është si më poshtë:

Koha e mbetur e përdorimit = Koha e përgjithshme teknike e përdorimit – Numri i viteve që aseti është në përdorim

Numri i viteve që aseti është në përdorim = Data e privatizimit (31.5.2009) - Data e kapitalizmit të asetëve

Jetëgjatësia mesatare e përdorimit të mbetur për klasën e asetëve është përcaktuar më pas si një mesatare e kohës së mbetur të përdorimit të asetëve individuale për klasën perkateseperkatese të asetëve.

Tabela e mëposhtme tregon kohën e mbetur të përdorimit për asetet e vjetëruara për klasat e asetëve perkatese:

Klasa e Aseteve	Jetëgjatësia e mbetur mesatare në vite
Toka me Ndertesa	N/A
Toka & Permiresim toke	13
Ndertesa Teknike	13
Makineri dhe Pajisje te tjera	9
Sistemi i Matjes	4
Pajisje pune te renda	2
Furnitura dhe instalime	2
Pajisje kompjuterike	2

Amortizimi i asetëve të reja është llogaritur duke aplikuar normën me norma fiskale të amortizimit në vlerën bruto individuale të asetit ose vlerën neto, rast që mund të jetë në përputhje me legjislacionin e shqiptar të taksave dhe rregulloret në fuqi të vitit për të cilin

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 35 nga 80

amortizimi është llogaritur. Për asetet e 2011, amortizimi i llogaritur përfshin metodat e amortizimit dhe përqindjet e vlefshme për 2010.

4.3.1. Amortizimi për vitin 2008

Amortizimi i asetëve të vjetra:

Baza e asetëve që nga 31 dhjetori 2007 në vlerën 1 329 mil lekë – amortizimi për të gjithë vitin në klasat perkatese të asetëve bazohet në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit .

Shtesat e 2008-ës në vlerën prej 1 953,5 mil. Lekë janë reduktuar me 770 mil. lekë të granteve të përdorura për financimin e këtyre shtesave – amortizimi për gjysmën e vitit bazohet në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit.

Amortizimi i asetëve të reja:

Nuk ka asetë të reja të amortizuara të vitit 2008.

4.3.2. Amortizimi për vitin 2009

Amortizimi i asetëve të vjetra:

Baza e asetëve që nga 31 dhjetori 2007 në vlerën 16 329 mil lekë – amortizimi për të gjithë vitin në klasat perkatese të asetëve bazohet në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit .

Shtesat e 2008-ës në vlerën prej 1 953,5 mil. Lekë janë reduktuar me 770 mil. lekë të granteve të përdorura për financimin e këtyre shtesave – amortizimi për gjysmën e vitit bazohet në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit .

Asetet e transferuara në OSSH duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 218, datë 06.03.2009, në vlerën prej 1 100 mil. Lekë përfshijë klasat e makinerive dhe pajisjeve të

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 36 nga 80

vjetra – vit i plotë i amortizimit të aseteve duke u bazuar në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit.

Shtesat nga 1 janari 2009 deri në 31 maj 2009 në vlerën prej 3 287,2 mil lekë – amortizim i drejtpërdrejtë i klasave të aseteve bazohet në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit vetëm për 7 muaj (duke marrë në konsideratë të gjitha asetet e blera nga 31 maji 2009).

Amortizimi i aseteve të reja:

Shtesat nga 1 qershori 2009 deri më 31 dhjetor 2009 në vlerën prej 617,7 mil. Lekë – amortizimi aktual me norma fiskale llogaritet duke u bazuar në datën e kapitalizmit.

4.3.3. Amortizimi për vitin 2010

Amortizimi i aseteve të vjetra:

Baza e aseteve që nga 31 dhjetori 2007 në vlerën 16 329 mil lekë – amortizimi i drejtpërdrejtë për të gjithë vitin në klasat perkatese të aseteve bazohet në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit .

Shtesat e 2008-ës në vlerën prej 1 953,5 mil. Lekë janë reduktuar me 770 mil. lekë të granteve të përdorura për financimin e këtyre shtesave – amortizimi për gjysmën e vitit bazohet në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit.

Asetet e transferuara në OSSH duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave no. 218, datë 06.03.2009, në vlerën prej 1100 mil. Lekë përfshijë klasat e makinerive dhe pajisjeve të vjetra – vit i plotë i amortizimit të aseteve duke u bazuar në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit .

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 37 nga 80

Shtesat nga 1 janari 2009 deri në 31 maj 2009 në vlerën prej 3 287,2 mil lekë – amortizim i drejtpërdrejtë i klasave të aseteve bazohet në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit vetëm për 7 muaj (duke marrë në kosideratë të gjitha asetet e blera nga 31 maji 2009).

Amortizimi i aseteve të reja:

Shtesat nga 1 qershori 2009 deri më 31 dhjetor 2009 në vlerën prej 617,7 mil. Lekë – amortizimi me norma fiskale i vitit të plotë aktual.

Shtesat nga 1 janari 2010 deri në 30 qershor në vlerën prej 947,2 mil. Lekë – amortizimi me norma fiskale aktual llogaritet duke u bazuar në datën e kapitalizmit.

Shtesat nga 1 qershori 2010 deri më 31 dhjetor 2010 në vlerën prej 3 593 mil lekë – vlera mesatare të amortizimi i vitit taksor bazohet në klasat e aseteve të ndara në katër (1/4 e amortizimit vjetor).

4.3.4. Amortizimi për vitin 2011

Amortizimi i aseteve të vjetra:

Baza e aseteve që nga 31 dhjetori 2007 në vlerën 16 329 mil lekë – amortizimi i drejtpërdrejtë për të gjithë vitin në klasat perkatese të aseteve bazohet në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit.

Shtesat e 2008-ës në vlerën prej 1 953,5 mil. Lekë janë reduktuar me 770 mil. lekë të granteve të përdorura për financimin e këtyre shtesave – amortizimi për gjysmën e vitit bazohet në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit.

Asetet e transferuara në OSSH duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave no. 218, datë 06.03.2009, në vlerën prej 1100 mil. Lekë përfshijë klasat e makinerive dhe pajisjeve të vjetra – vit i plotë i amortizimit të aseteve duke u bazuar në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit .

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 38 nga 80

Shtesat nga 1 janari 2009 deri në 31 maj 2009 në vlerën prej 3 287,2 mil lekë – amortizim i drejtpërdrejtë i klasave të aseteve bazohet në llogaritjen e kohës së mbetur të përdorimit vetëm për 7 muaj (duke marrë në konsideratë të gjitha asetet e blera nga 31 maji 2009).

Amortizimi i aseteve të reja:

Shtesa nga 1 qershori deri më 31 dhjetor 2009 në vlerën prej 617,7 mil. lekë - amortizimi me norma fiskale i vitit të plotë aktual.

Shtesat nga 1 janari 2010 deri në 30 qershor 2010 në vlerën prej 947,2 mil. lekë – amortizimi me norma fiskale i vitit të plotë aktual.

Shetsat nga 1 qershori 2010 deri në 31 dhjetor 2010 në vlerën prej 3 593 mil lekë – vlera mesatare e amortizimit bazohet në klasën e aseteve.

Shesat e 2011 në vlerën prej 4 896 mil lekë – vlera mesatare e amortizimit bazohet në klasën e aseteve të ndara në dy të tilla.

Një përmbledhje grafike e tekstit të mësipërm është bashkëlidhur si Shtojca no. 4.

Llogaritjet pasqyrohen gjithashtu në tabelën e mëposhtme:

**Asetet e vjetra - para dates se blerjes
Amortizimi i vitit 2008 (ne mije Leke)**

Pershkrimi i klasave te aseteteve	Vlera bruto e aseteteve (BoP)	Shtesat	Amortizimi	Vlera bruto e aseteteve (EoP)	Amortizimi kumulativ	Vlera neto e aseteteve (EoP)
Toka me Ndertesa	334,259	0	0	334,259	0	334,259
Toka & Permiresim toke	690,412	0	53,109	690,412	53,109	637,303
Ndertesa Teknike	1,352,792	98,173	107,837	1,450,965	107,837	1,343,128
Ndertime	0	0	0	0	0	0
Makineri dhe Pajisje te tjera	12,974,644	2,158,796	1,500,449	15,133,440	1,500,449	13,632,991
	0	0	0	0	0	0
Sistemi i Matjes	558,764	0	139,691	558,764	139,691	419,073
Pajisje pune te renda	203,799	10,475	104,518	214,274	104,518	109,756
Furnitura dhe instalime	10,941	16,077	9,490	27,017	9,490	17,528
Pajisje kompjuterike	0	0	0	0	0	0
Pajisje te teknologjise informatike	203,389	0	101,694	203,389	101,694	101,694
Totali	16,329,000	2,283,520	2,016,788	18,612,520	2,016,788	16,595,732

Amortizimi i vitit 2009 (ne mije Leke)

Pershkrimi i klasave te aseteteve	Vlera bruto e aseteteve (BoP)	Shtesat	Amortizimi	Vlera bruto e aseteteve (EoP)	Amortizimi kumulativ	Vlera neto e aseteteve (EoP)
Toka me Ndertesa	334,259	43,381	0	377,640	0	377,640
Toka & Permiresim toke	690,412	89,676	57,133	780,088	110,241	669,847
Ndertesa Teknike	1,450,965	335,807	126,681	1,786,772	234,518	1,552,254
Ndertime	0	0	0	0	0	0
Makineri dhe Pajisje te tjera	15,133,440	2,562,013	1,847,550	17,695,453	3,347,999	14,347,454
	0	0	0	0	0	0
Sistemi i Matjes	558,764	173,350	164,971	732,114	304,662	427,452
Pajisje pune te renda	214,274	37,864	118,181	252,138	222,699	29,439
Furnitura dhe instalime	27,017	10,320	16,519	37,337	26,008	11,329
Pajisje kompjuterike	0	0	0	0	0	0
Pajisje te teknologjise informatike	203,389	34,796	111,843	238,185	213,538	24,647
Totali	18,612,520	3,287,206	2,442,877	21,899,726	4,459,665	17,440,061

Amortizimi i vitit 2010 (ne mije Leke)

Pershkrimi i klasave te aseteteve	Vlera bruto e aseteteve (BoP)	Shtesat	Amortizimi	Vlera bruto e aseteteve (EoP)	Amortizimi kumulativ	Vlera neto e aseteteve (EoP)
Toka me Ndertesa	377,640	0	0	377,640	0	377,640
Toka & Permiresim toke	780,088	0	60,007	780,088	170,248	609,840
Ndertesa Teknike	1,786,772	0	137,444	1,786,772	371,962	1,414,810
Ndertime	0	0	0	0	0	0
Makineri dhe Pajisje te tjera	17,695,453	0	1,966,161	17,695,453	5,314,160	12,381,292
	0	0	0	0	0	0
Sistemi i Matjes	732,114	0	183,028	732,114	487,691	244,423
Pajisje pune te renda	252,138	0	21,551	252,138	244,250	7,888
Furnitura dhe instalime	37,337	0	9,179	37,337	35,187	2,150
Pajisje kompjuterike	0	0	0	0	0	0
Pajisje te teknologjise informatike	238,185	0	17,398	238,185	230,936	7,249
Totali	21,899,726	0	2,394,768	21,899,726	6,854,433	15,045,293

Amortizimi i vitit 2011 (ne mije Leke)

Pershkrimi i klasave te aseteteve	Vlera bruto e aseteteve (BoP)	Shtesat	Amortizimi	Vlera bruto e aseteteve (EoP)	Amortizimi kumulativ	Vlera neto e aseteteve (EoP)
Toka me Ndertesa	377,640	0	0	377,640	0	377,640
Toka & Permiresim toke	780,088	0	60,007	780,088	230,255	549,833
Ndertesa Teknike	1,786,772	0	137,444	1,786,772	509,406	1,277,366
Ndertime	0	0	0	0	0	0
Makineri dhe Pajisje te tjera	17,695,453	0	1,966,161	17,695,453	7,280,322	10,415,131
	0	0	0	0	0	0
Sistemi i Matjes	732,114	0	183,028	732,114	670,719	61,395
Pajisje pune te renda	252,138	0	7,888	252,138	252,138	0
Furnitura dhe instalime	37,337	0	2,150	37,337	37,337	0
Pajisje kompjuterike	0	0	0	0	0	0
Pajisje te teknologjise informatike	238,185	0	7,249	238,185	238,185	0
Totali	21,899,726	0	2,363,928	21,899,726	9,218,361	12,681,365

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Asetet e reja - pas dates se blerjes
Amortizimi i vitit 2008 (ne mije Leke)

Pershkrimi i klasave te aseteteve	Vlera bruto e aseteteve (BoP)	Shtesat	Amortizimi	Vlera bruto e aseteteve (EoP)	Amortizimi kumulativ	Vlera neto e aseteteve (EoP)
Toka me Ndertesa	0	0	0	0	0	0
Toka & Permiresim toke	0	0	0	0	0	0
Ndertesa Teknike	0	0	0	0	0	0
Ndertime	0	0	0	0	0	0
Makineri dhe Pajisje te tjera - 20%	0	0	0	0	0	0
Makineri dhe Pajisje te tjera - 5% rate	0	0	0	0	0	0
Sistemi i Matjes	0	0	0	0	0	0
Pajisje pune te renda	0	0	0	0	0	0
Furnitura dhe instalime	0	0	0	0	0	0
Pajisje kompjuterike	0	0	0	0	0	0
Pajisje te teknologjise informatike	0	0	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0	0	0

Amortizimi i vitit 2009 (ne mije Leke)

Pershkrimi i klasave te aseteteve	Vlera bruto e aseteteve (BoP)	Shtesat	Amortizimi	Vlera bruto e aseteteve (EoP)	Amortizimi kumulativ	Vlera neto e aseteteve (EoP)
Toka me Ndertesa	0	0	0	0	0	0
Toka & Permiresim toke	0	0	0	0	0	0
Ndertesa Teknike	0	33,455	609	33,455	609	32,846
Ndertime	0	0	0	0	0	0
Makineri dhe Pajisje te tjera - 20%	0	66,229	431	66,229	431	65,798
Makineri dhe Pajisje te tjera - 5% rate	0	414,308	3,972	414,308	3,972	410,336
Sistemi i Matjes	0	56,921	317	56,921	317	56,604
Pajisje pune te renda	0	1,749	176	1,749	176	1,573
Furnitura dhe instalime	0	29,497	81	29,497	81	29,416
Pajisje kompjuterike	0	1,973	0	1,973	0	1,973
Pajisje te teknologjise informatike	0	13,522	748	13,522	748	12,774
Totali	0	617,654	6,334	617,654	6,334	611,320

Amortizimi i vitit 2010 (ne mije Leke)

Pershkrimi i klasave te aseteteve	Vlera bruto e aseteteve (BoP)	Shtesat	Amortizimi	Vlera bruto e aseteteve (EoP)	Amortizimi kumulativ	Vlera neto e aseteteve (EoP)
Toka me Ndertesa	0	0	0	0	0	0
Toka & Permiresim toke	0	0	0	0	0	0
Ndertesa Teknike	33,455	35,623	2,981	69,079	3,590	65,488
Ndertime	0	56,832	1,678	56,832	1,678	55,154
Makineri dhe Pajisje te tjera - 20%	66,229	126,368	31,764	192,597	32,195	160,402
Makineri dhe Pajisje te tjera - 5% rate	414,308	2,991,017	67,484	3,405,324	71,456	3,333,868
Sistemi i Matjes	56,921	1,126,827	92,636	1,183,749	92,953	1,090,796
Pajisje pune te renda	1,749	0	315	1,749	491	1,258
Furnitura dhe instalime	29,497	124,400	12,865	153,897	12,946	140,951
Pajisje kompjuterike	1,973	75,446	13,351	77,418	13,351	64,067
Pajisje te teknologjise informatike	13,522	3,754	3,795	17,277	4,543	12,734
Totali	617,654	4,540,267	226,868	5,157,921	233,202	4,924,719

Amortizimi i vitit 2011 (ne mije Leke)

Pershkrimi i klasave te aseteteve	Vlera bruto e aseteteve (BoP)	Shtesat	Amortizimi	Vlera bruto e aseteteve (EoP)	Amortizimi kumulativ	Vlera neto e aseteteve (EoP)
Toka me Ndertesa	0	0	0	0	0	0
Toka & Permiresim toke	0	0	0	0	0	0
Ndertesa Teknike	69,079	0	3,274	69,079	6,865	62,214
Ndertime	56,832	0	2,758	56,832	4,436	52,396
Makineri dhe Pajisje te tjera - 20%	192,597	491,879	81,268	684,476	113,463	571,013
Makineri dhe Pajisje te tjera - 5% rate	3,405,324	2,705,794	237,911	6,111,118	309,367	5,801,751
Sistemi i Matjes	1,183,749	1,381,239	356,283	2,564,987	449,236	2,115,751
Pajisje pune te renda	1,749	0	252	1,749	742	1,007
Furnitura dhe instalime	153,897	265,000	54,690	418,897	67,636	351,261
Pajisje kompjuterike	77,418	52,088	22,528	129,506	35,879	93,628
Pajisje te teknologjise informatike	17,277	0	3,184	17,277	7,726	9,551
Totali	5,157,921	4,896,000	762,148	10,053,921	995,350	9,058,571

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

4.4. Llogaritja e kostos mesatare të ponderuar të kapitalit - (WACC)

4.4.1. Llogaritja e kthimit të lejuar nga Kapitali

Përqindja e AroE (kthimit të lejuar nga kapitali) përcaktohet në bazë të Deklaratës Rregullatore deri në nivelin **16,44%**.

4.4.2. Kostot e borxheve të vjetra

“Borxhet e vjetra”, siç janë përcaktuar edhe në Deklaratën Rregullatore janë kreditë e transferuara ndaj OSSH nga KESH duke u bazuar në “Marrëveshjen e riparimit të borxhit afatgjatë”. Llogaritja bazohet në shumat e pashlyera të kredive perkatëse në valutën e tyre kontraktuese dhe programin e pagesës për pjesën e mbetur të 2010 dhe 2011. Më pas, vlerat rillogariten në lek, duke përdorur vlerën mesatare të shkëmbimit aktual të lekut përkundrejt monedhes perkatëse ose kur kjo gjë nuk është e mundur, përdoret kalkulimi i terthorte nëpërmjet Euros. Mesatarja e interesit llogaritet më pas duke u bazuar në shumat e papaguara aktuale. Tabela e mëposhtme jep një përmbledhje të vlerave në lek. Përmbledhje e detajuar e borxheve të vjetra dhe llogaritjet perkatëse janë dhënë në Shtojcën Nr. 5.

Totali i Borxhit të Keq

Celja në fillim të vitit
Disbursimi
Instalimi
Pagesa principale
Interesat
Shuma në fund të vitit

Mesatarja e ponderuar e normes së interesit të Borxhit të Vjetër

Monedha Leke	
2010	2011
13,516	12,186
0	0
1,395	1,354
1,146	1,136
249	217
12,370	11,049
1.85%	1.78%

Fig.. Përmbledhje e përqindjes mesatare të interesit “borxheve të vjetra”

Nëpërmjet tabelës – do të dëshironim të theksojmë se shumat vjetore për 2010 dhe shuma e hapjes së 2011 nuk janë të njëjta, për shkak se çdo vit ka kurse këmbimi të ndryshme. (Shih Shtojcën nr. 5)

4.4.3. Kostot e borxheve të reja

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Duke u bazuar në negociatat e shumta me bankat lokale, OSSH pranon se ekzistojnë burime të kufizuara të disponueshme në nivel lokal dhe se mundësitë e bankave lokale për të ofruar financime afatgjata, të cilat do të plotësonin nevojat për investime për OSSH nuk janë të mjaftueshme. Në fakt, bankat lokale janë në gjendje të ofrojnë vetëm financime afatshkurtra në formën e over-drafteve, gjë që është përdorur nga OSSH për të financuar aktivitete operative. Bazuar në këtë, OSSH ka hyrë në negociata me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe International Finance Corporation (IFC) për financime afatgjata të programit të investimit të OSSH në shumën e përgjithshme prej 100 milionë Euro. Bisedimet fillestare kanë rezultuar në firmosje e letrave mandatuese më 1 shkurt 2010, të cilat specifikojnë afatet dhe kushtet sipas të cilave institucioni financiar do të jetë i gatshëm të japë kredi. Negociatat janë ngrirë brenda gjysmës së parë të 2010 sepse të dyja bankat u vunë në dijeni të konfliktit ndërmjet ERE dhe OSSH në lidhje me vendimi për tarifën e vitit 2010. Negociatat kanë rifilluar gjatë periudhës së verës dhe OSSH pret t'i finalizojë ato nga fundi i 2010-ës. Pagesa e parë e kredisë pritet të ndodhë rreth nëntorit të vitit 2010. Ndonëse kontrata përfundimtare nuk është përmbyllur akoma, ne kemi përdorur afatet dhe kushtet e letrave mandatuese për qëllim të llogaritjes – letra e Mandatit nga EBRD pasqyrohet në **Shtojcën nr. 6**.

Një ekstrakt i Afateve & Kushteve të propozuar nga EBRD & IFC për financime afatgjata për programin e investimit të OSSH:

- Maturimi – 12 vjet
- Periudhe faljeje – 3 vjet
- Norma e interesit – 6M EURIBOR + 9,25%
- Garancia – Garanci e Sponsorizuar p.sh Garanci nga kompania Meme nga ČEZ, a.s.
- Tarifa e administrimit – vjetore – 15 000 EUR
- Tarifa e vlerësimit – Pagese Ndermarrjeje – EUR 120 000 upfront – pagesë në avancë

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 43 nga 80

OSSH parashikon se pagesën e kredisë brenda 2010 dhe 2011 si më poshtë:

Kësti i parë në 2010 – 40 milionë Euro për të mbuluar investimin e 2010 e financiar fillimin nga kredia nga ČEZ, a.s.

Kësti i dytë në 2011 – 36,19 milionë Euro për të mbuluar programin e investimit të 2011.

Kjo paraqet 10 309 milionë lekë nëpërmjet përdorimit të përqindjës mesatare të shkëmbimit të pritshëm për 2011.

6M EURIBOR i përdorur për llogaritjen është 1,004% që është mesatarja e ditëve të para të muajit brenda 2010 (burimi: www.euribor-rates.eu)

Raporti ne ditën e parë të muajit	1.004%
2/8/2010	1.145%
1/7/2010	1.056%
1/6/2010	0.991%
3/5/2010	0.971%
1/4/2010	0.945%
1/3/2010	0.959%
1/2/2010	0.966%
4/1/2010	0.996%

Bazuar si më sipër – norma e interesit për Borxhin e Ri është 10,254%.

4.4.4. Formula e llogaritjes së WACC

Llogaritja e WACC bazohet në formulën e dhënë në Deklaratën Rregullatore në seksionin 4.2, si më poshtë:

$$WACC = 40\% * Pre\ tax\ AROE\% + 60\% (Y1\% + Y2\%)$$

Në të cilën:

Aplikimi i tarifave për vitin 2011

OSSH, Sh.a.; Blloku „Vasil Shanto“, Tirana, Albania

Faqe 44 nga 80

$$Y1\% = CoOD\% * \frac{OldL - T}{(OldL - T + NewL - T)}$$

$$Y2\% = CoND\% * \frac{NewL - T}{(OldL - T + NewL - T)}$$

Më pas, llogaritja bëhet si më poshtë:

$$Y1\% = 1,784\% * \frac{12'186}{(12'186 + 10'308)} = 0,97\%$$

$$Y2\% = 10,254\% * \frac{10'308}{(12'186 + 10'308)} = 4,70\%$$

Llogaritja përfundimtare e WACC është më pas si vijon:

$$WACC = 40\% * 16,44\% + 60\% * (0,97\% + 4,70\%) = 9,98\%$$

4.5. Kapitali punues (Working capital)

WC përcaktohet sipas Deklaratës Rregullatore, seksioni 4.4, OPEX/12.

4.6. Baza e rregulluar e aseteve (RAB)

Sipas nenit 4 “Për shpërndarjen e tarifës së shërbimit”, pika 4.1 të Deklaratës Rregullatore, ne po e llogarisim RAB si më poshtë:

